



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS SLLAVO-BALLKANIKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Metodologji e kërkimit shkencor dhe kërkim
në kontekstin pedagogjik të gjuhës së huaj

Ngarkesa: 6 kredite; 60 orë mësimore; 30 leksione / 30 seminare

Viti / Semestri : Viti II, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master Shkencor Mësuesi /Gjuhë Turke

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Të zhvillojë strategji për formulimin e çështjeve të kërkimit, për mbledhjen dhe analizimin e të dhëna që kanë lidhje me këto çështje Të ndërtojë dhe komunikojë kërkimin duke u bazuar në teknika cilësore të kërkimit. Të nxjerrë perspektivën epistemologjike që përshkron çdo kërkim në gjuhësinë e aplikuar.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të dijë të justifikojë kriteret e përdorura për matjet dhe vlerësimet e bëra për gjuhën gjatë studimit,
2. Të komunikojë rezultatet e punimit në mënyrë që të shpjegohet qartë lidhja e tyre me lexuesin dhe studjuesin që ndjek punimin si dhe të ketë vlera referuese për të ardhmen
3. Të identifikojë konsekuencat shoqërore të kërkimeve në gjuhësinë e aplikuar.
4. Të vlerësojë në mënyrë kritike studimet e botuara në fushën e gjuhësisë së aplikuar

Rezultatet e pritshme:

1. Formulojë në mënyrë të argumentuar një çështje kërkimore, të mbledhë dhe analizojë të dhëna në përputhje me teknikat cilësore të kërkimit në gjuhësinë e aplikuar.
2. Zbatojë kriteret të justifikuar për matjen dhe vlerësimin e dukurive gjuhësore, si dhe të nxjerrë përfundime të mbështetura teorikisht dhe praktikisht.
3. Komunikojë qartë dhe në mënyrë strukturuar rezultatet e kërkimit, duke i lidhur ato me qëllimin fillestar të studimit dhe me nevojat e lexuesit/studjuesit.
4. Vlerësojë në mënyrë kritike dhe të pavarur literaturën ekzistuese, si dhe të kuptojë ndikimet dhe kontekstin shoqëror të kërkimeve në fushën e gjuhësisë së aplikuar.